



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Rektor i UMIB-it

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1397/004

Dt 10. 10. 2017

Në bazë të nenit 48 pika 1.3, nenit 154 dhe nenit 155 të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, mori:

**VENDIM**

1. **Dr. sc. Ahmet Latifi** zgjidhet **profesor i rregullt** për lëndët: Mekanikë I Statikë; Rezistenca e materialeve; Kinematikë; Dinamikë; dhe Organizimi dhe efikasiteti i prodhimit, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.
2. Zgjedhja e të përmendurit është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 155 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
3. I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statutit të Përkohshëm të Universitetit.
4. Emërimi dhe kohëzgjatja e punësimit bëhet për kohë të pacaktuar.
5. Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhura personale të UMIB-it.
6. Kontrata e punës me të përmendurin do të lidhet nga data 3.10.2017, pas deklarimit për pagë primare në UMIB.

**Arsyetim**

Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Mekanikë I Statikë; Rezistenca e materialeve; Kinematikë; Dinamikë; dhe Organizimi dhe efikasiteti i prodhimit, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.

Këshilli i Fakultetit e ka shqyrtuar raportin e Komisionit recensues dhe i ka propozuar Senatit të Universitetit që dr. sc. Ahmet Latifi të zgjidhet profesor i rregullt për lëndët e sipërpërmendura.

**Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 3.10.2017, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për Studime, vendosi që dr. sc. Ahmet Latifi të zgjidhet profesor i rregullt për lëndët: Mekanikë I Statikë; Rezistenca e materialeve; Kinematikë; Dinamikë; dhe Organizimi dhe efikasiteti i prodhimit, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike.**

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit për paga;
6. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Rektor i UMIB-it